



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.1117/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialeve zgjedhore në rrugë publike për qëllime elektorale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar** ankesa e evidentuar me numër Anr.1117/2021 e datës 12.11.2021 e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje t'i shqiptohet gjobë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike- vendosjes së materialeve zgjedhore në rrugë publike për qëllime elektorale.

#### **A r s y e t i m**

PZAP, ka pranuar ankesën Anr.1117/2021 e datës 14.11.2021 nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendon se me datë 12.11.2021 rreth orës 12:00, aktivistët e këtij subjekti kanë vërejtur se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë vendosur material zgjedhor (përfshirë fotografi të mëdha në formë pikturë e të ngjashme) në lokacionin Sheshi “Nënë Terezë”, të cilat veprime parashtruesi thekson se janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Subjektit Politik LDK-së, paraqitur kundër Subjektit Politik LVV-së, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar po nga i njëjti subjekt për të cilin është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.1105/2021 të datës 11.11.2021. Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se pretendimi nga ankesa e parashtruara nga LDK, paraqitur kundër LVV, është konsumuar me vendimin e cekur më lartë.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.1105/2021 të datës 11.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1117/2021 më datën 15.11.2021

**Kryesuese e Panelit**  
**Milena Đerić**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.